

KENI NJË SHQETËSIM?

- **Telefononi 311** ose **(718) 557-1399** për të kërkuar lidhjen me Shelter Hotline
- **Kontakttoni me email Avokatin e Popullit** në adresën ombudsman@dss.nyc.gov
- **Kontakttoni me email Zyrën e DSS-së për çështjet e LGBTQI** në adresën lgbtqi@dss.nyc.gov
- **Vizitoni Avokatin e Popullit:** Nga e hëna deri të premten, orari 09:00 - 16:00
109 E. 16th St, 8th Fl
New York, NY 10003

Ju gëzoni të drejtën që të mos penalizoheni nëse bëni një ankesë.

Nëse keni raportuar për ngacmim, diskriminim ose penalizim me bazë gjinore dhe jeni të pakënaqur me zgjidhjen, mund të kërkonit një shqyrtim ligjor.



Skanoni për më shumë informacion mbi burimet e ofruara nga:

Zyra e Kryetarit të Bashkisë për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore:



Projekti kundër dhunës:




Procedura e DHS-së për klientët transgjinerë, jobinarë dhe ndërseksualë:



 @NYCDHS

 @NYCDHS

 @DHSOFNYC

 @NYC Homeless Services

BRC-1062 (AL) 08/07/2024
(E) Rev. 07/2024

© E drejta e autorit 2024. Qyteti i Nju-Jorkut, Departamenti i Shërbimeve Sociale. Për autorizimin e riprodhimit të gjithë materialit ose një pjese të tij kontaktoni me Departamentin e Shërbimeve Sociale të qytetit të Nju-Jorkut.

NYC
Department of
Homeless Services
Department of
Social Services



Kjo është një hapësirë e sigurt e afirmimit të identitetit gjinor (TGNC)

BRC-1062 (AL)

NJIHNI TË DREJTAT TUAJA

A identifikoheni si person transgjinator, jokonform ndaj gjinisë, jobinar ose ndërseksual?

Pavarësisht se ku ndodheni në sistemin e DHS-së, keni të drejtën të mos ngacmoheni ose diskriminoheni për shkak të gjinisë apo identitetit tuaj gjinor.

Ju keni të drejtën të përdorni dhe t'ju thërrasin sipas emrit, përemrit dhe titullit tuaj të preferuar.

Keni të drejtë të mbani emrin tuaj ligjor, gjininë e përcaktuar në lindje, statusin TGNC dhe konfidencialitetin në lidhje me aftësinë e kufizuar.

SHTRETËR AKOMODUES NË MBËSHTETJE TË PERSONAVE QË KËRKOJNË AFIRMIMIN E IDENTITETIT GJINOR

DHS ka vënë në dispozicion shtretër akomodues posaçërisht për personat TGNC. Këta shtretër akomodues ndodhen në qendrat e strehimit për burra dhe gra në Manhattan, Bronx, Brooklyn dhe Queens. Ata ndodhen në dhoma të vogla në një hapësirë të përbashkët, që kanë ose janë afër tualeteve dhe dusheve individuale apo banjave private.

Nëse jeni të interesuar, pyesni një pjesëtar të stafit të regjistrimeve ose menaxherin e rastit tuaj. Qëndrimi në këta shtretër akomodues të veçuar është opsional.

SHËNIM

A keni një aftësi të kufizuar?

Nëse keni një aftësi të kufizuar, keni të drejtën e akomodimit në lidhje me aftësinë tuaj të kufizuar, në mënyrë që të merrni ndihmën që ju nevojitet.

Po ju transferojnë?

Nëse nuk jeni dakord me vendimin e transferimit, do të transferoheni gjithsesi. Megjithatë, mund t'i kërkonit stafit të qendrës së strehimit "Të drejtat e transferimit" në gjuhën tuaj të preferuar dhe/ose të kërkonit një seancë dëgjimore objektive duke telefonuar në numrin **800-342-3334** ose duke dorëzuar një formular kërkesë online në adresën <http://www.otda.ny.gov/oah/forms.asp>.